



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:286068
Datë: 05.07.2024
Numri i dokumentit: 05923939

C.nr.2298/23

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala, me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit J. K. nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universal i Kosovës-Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.R., me objekt kontesti për anulimin e vendimeve dhe kthimin në punë, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur, në prezencën e të autorizuarve të paditësit dhe të paditurës, me datë 05 korrik 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit J. K. nga Gjakovës, me të cilën ka kërkuar që të: *“Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të Anulohet vendimi i SH.S.K.U.K-Qendra Kombëtare e Mjekësisë së punës në Gjakovë, me nr. 685, i datës 31.10.2023 dhe Vendimi i Komisionit të Ankesave të SH.S.K.U.K- Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, nr. 803, i datës 30.11.2023 si jo ligjorë si dhe kthimi i paditësit në vendin e tij të punës. Detyrohet e paditura që paditësit të ia paguaj shpenzimet procedurale në afat prej 7 ditëve pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.”*

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

- *Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësi J. K. nga Gjakova, përmes të autorizuarit të tij Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, pranë kësaj gjykate me datë 08.12.2023, ka parashtruar padi ndaj të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universal i Kosovës- Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë për shkak të anulimit të vendimeve dhe kthimin në punë të paditësit. Në padi ka theksuar e paditura me vendim për ndërprerje të kontratës së punës, të datës 31.10.2023 ka vendosur që paditësit, i sistemuar në vendin e punës si teknik në laboratorin biokimik hematologjik, të ia ndërprejnë marrëdhënien e punës, sipas fuqisë ligjore me datë 01.11.2023, për shkak të shqiptimit të dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje nga Gjykata Themelore

në Gjakovë. Kundër të njëjtit vendim paditësi, ka paraqitur ankesë me datë 31.10.2023, të cilën ankesë e paditura e ka refuzuar si të pa bazuar me datë 30.11.2023. po ashtu ka theksuar se e paditura gabimisht ka vlerësuar të drejtën materiale duke iu referuar nenit 73 par. 6 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyratet Publik dhe atë të nenit 67, pika 1.6 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenit 60 par. 1.6 të Ligjit nr. 06/L-114 për zyratet publik duke shtuar se nuk janë zbatuar dispozitat më të favorshme, janë shkelur edhe të drejtat e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNJ-se. Po ashtu ka theksuar se ekzistojnë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës administrative sepse vendimi në fjalë nuk i plotëson elementet dhe kriteret e detyrueshme që duhet të ketë një akt administrativ konform dispozitave të ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative. Përgjatë seancës përgatitore i autorizuari i paditësit ka bërë ndryshimin e petitutim të padisë duke shtuar edhe një kërkesë tjetër krahas asaj ekzistuese, përkatësisht kërkesa që ka të bëjë me kthimin e paditësit në vendin e tij të punës. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e paditësit, të anulohet vendimi i SHKUKS-Qendrës Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, me nr. 685, i datës 31.10.2023 dhe Vendimi i Komisionit të Ankesave të paditurës, nr. 803, i datës 30.11.2023 si jo ligjore. Po ashtu ka kërkuar kthimin e paditësit në vendin e punës si dhe shpenzimet procedurale.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar e mbetet në tërësi pranë padisë, kërkesëpadiisë, si dhe pretendimeve përgjatë seancave. Ka theksuar se sa i përket vendimeve e palës së paditur, të njëjtat janë kundërligjore dhe nuk janë të bazuara në ligj, duke pasur parasysh se pala paditëse ka qenë në periudhën më të shkurtër se gjashtë (6) muaj në vuajtje të dënimi, këtë duke pasur parasysh dhe se i njëjti ka qenë në pushim mjekësor, para se të bëhet apo të arrihet periudha gjashtë (6) mujore. Sa i përket vendimit të palës së paditur, ku shkëputjen e kontratës e bazon në Ligjin e ri për Zyratet Publik, i njëjti nuk mund të aplikohet në rastin e paditësit duke pasur parasysh se dënimi i shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë është ndërmarrë para se të hyjë në fuqi Ligji i ri për Zyratet Publik, ashtu që në këtë çështje është dashur të aplikohen dispozitat e Ligjit të vjetër. Ka shtuar se pala paditëse e ka marrë pushimin mjekësor në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh dhe për këtë fakt. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se në këtë çështje, pas administrimit të provave është vërtetuar se aktgjykimi penal i Gjykatës Themelore në Gjakovë, është marrë para hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyratet Publik, për të cilin e paditura, ka marrë veprime për paditësin. Në këtë çështje, siç e kemi cekur edhe në padi, duhet të aplikohen dispozitat më të favorshme të Ligjit paraprak, pasi që ai ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi është gjykuar penalisht. Andaj, pas administrimit të provave, është vërtetuar se vendimet e atakuar me padi janë kundër ligjore dhe të njëjtat duhet të anulohen, ashtu që Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadiinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 euro, dhe për dy (2) seanca nga 135.20 euro secila, në shumë prej 374.40 euro.

E paditura përmes të autorizuarës të saj ka parashtruar përgjigjen në padi me datë 11.03.2024 me anë të cilës e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar ngase vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës së paditësit është ndërmarrë në përputhje të plotë me dispozitat në fuqi. Ka theksuar se paditësi ka qenë në pushim mjekësor pa pagesë 3 mujor për periudhat 21.06.2023

deri me 20.07.2023, 21.07.2023 deri me 20.08.2023 si dhe prej 21.09.2023 deri me 20.10.2023. i njëjti pas përfundimit të pushimit mjekësor ka qenë i obliguar të paraqitet në punë me datë 23.10.2023, mirëpo nuk është paraqitur dhe ditën e katër të mungesës në punë, e paditura i është drejtuar me email Gjykatë Themelore në Gjakovë lidhur me paditësin, meqenëse ndaj paditësi po zhvillohej procedura penale për vepër penale “Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par. 2 te KPRK-së. Me tutje ka theksuar se nga Gjykata Themelore në Gjakovë ka pranuar njoftimin me datë 30.10.2023 se paditësi është në vuajtje të dënimit nga data 11.07.2023 për veprën penale të lartcekur sipas aktgjyqimit të datës 23.03.2023, i plotfuqishëm me datë 26.05.2023 i cili është dënuar me një (1) vit e tre (3) muaj burgim si dhe me gjobë 600 euro. Po ashtu ka theksuar se paditësi sa ka qenë në marrëdhënie punë ka pasur statusin e zyrtarit publik për çka edhe është zbatuar ligji për zyrtaret publik me nr. 08//L-197. Gjithashtu e ka kundërshtuar edhe pretendimin se vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës si dhe ai i komisionit të ankesave nuk janë në përputhje me formën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

E paditura, përmes përfaqësueses së saj sipas autorizimit, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë si të pabazuar, duke theksuar se paditësi ka marrë pushim mjekësor pa pagesë para fillimit të mbajtjes së dënimit, pasi që paditësi ka qenë në pushim mjekësor pa pagesë, duke filluar nga data 21.06.2023, sipas kërkesës së datës 12.06.2023 dhe i njëjti, ka vazhduar pushimin mjekësor pa pagesë, deri me datë 20.10.2023. Ka shtuar se i punësuari J. K., pasi që është dënuar me vendim të formës së prerë, në zbatim të ligjshmërisë, sipas Ligjit për Zyrtarët publik, neni 73 pika 1), par 6), është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punës, pasi që ka qenë aktgjykim i formës së prerë, për vepër penale me dashje. I njëjti ka paraqitur kërkesë për pushim mjekësor, duke e ditur që aktgjykimi i tij është i plotfuqishëm dhe mund të zbatohet dënimi i përcaktuar dhe në këtë mënyrë, ka vënë në lajthitje edhe Institucionin. Në këtë mënyrë, në zbatim të ligjshmërisë, duke respektuar legjislacionin në fuqi, pra Ligjin për Zyrtarët Publik, neni 73 pika 1 par 6, ku sipas këtij neni, ka bazë për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit, sipas fuqisë ligjore. Gjithashtu, pretendimi i paraqitur në padi për zbatim të gabuar të drejtës materiale, nuk qëndron, për arsye se Ligji për Zyrtarët Publik përcakton se rregullon edhe pjesën e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit në raport me Ligjin e Punës. Po ashtu, pretendimi i paraqitur në padi së e nuk është marrë parasysh ligji më i favorshëm, nuk qëndron, pasi që institucionet publike zbatojnë legjislacionin në fuqi në fushën e punës dhe atë administrative, përkatësisht në rastin konkret, Ligji më i favorshëm penal nuk zbatohet në rastet e marrëdhënies së punës. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar ka se e paditura ka bërë ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit të paditësit, duke vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me rregullat e përgjithshme administrative, të zbatueshme brenda kompetencave tona dhe në përputhje me qëllimet që i janë vene këto kompetenca. Andaj gjykatës i ka propozuar që padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

- *Gjendja faktike e vërtetuar*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar këto prova : Vendimi i të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me numër 685, i datës 31.10.2023; Vendimi i komisionit të ankesave me numër 803, i datës 30.11.2023; Ankesa e ushtruar ndaj vendimit, e datës 01.11.2022; Kërkesa për pushim mjekësor pa pagesë, e datës 12.06.2023; Raporti Mjekësor, i datës 12.06.2023; Përgjigje në kërkesën për lejimin e pushimit mjekësor pa pagesë, e datës 20.06.2023; Përgjigje në kërkesën për lejimin e pushimit mjekësor pa pagesë, e datës 14.08.2023; Vendimin për lejimin e pushimit mjekësor pa pagesë, e datës 20.06.2023, me numër të prot. 368; Vendimi për lejimin e vazhdimit të pushimit mjekësor pa pagesë, me datë 14.08.2023, numër prot. 505/1; Përgjigje në kërkesën për lejimin e pushimit mjekësor pa pagesë, e datës 10.09.2023; Vendimi për lejimin e vazhdimit të pushimit mjekësor pa pagesë, me datë 19.09.2023, me numër prot. 573; si dhe Korrespondenca me Gjykatën – Emaillet dhe ato të datave 13.12.2022, 14.12.2022, 27.10.2023, 30.10.2023 ku ka qenë i bashkangjitur aktgjykimi dhe fakti se i njëjti është i plotfuqishëm nga data 26.05.2023.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje: LPK), arriti në përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë çështje juridike kontestimore në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi J. K. ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se paditësi ishte dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm, për shkak të kryerjes së veprës penale dhe i është shqiptuar dënimi në një (1) vit e tre (3) muaj burgim dhe dënim me gjobë. Të gjitha këto fakte palët i kanë pohuar në padi respektivisht gjatë seancave për shqyrtim kryesorë. Mirëpo kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte sa i përket ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga ana e të paditurës, se ky vendim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës a ishte marrë në harmoni me dispozitat ligjore.

Nga vendimi i të paditurës me nr. 685, i datës 31.10.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore me datë 01.11.2023, përkatësisht për shkak të shqiptimit të dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje.

Nga ankesa e paditësit e datës 07.11.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ndaj vendimit mbi largimin nga puna ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, për shkak të vërtetimit të gabuar, përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale.

Nga vendimi i të paditurës me nr. 803 i datës 30.11.2023 gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura e ka refuzuar ankesën e paditësit si e pa bazuar.

Nga kërkesa për pushim mjekësor pa pagesë e datës 12.06.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka parashtruar kërkesë për pushim mjekësor në afat një (1) vjet.

Nga raporti mjekësor, i datës 12.06.2023 gjykata ka vërtetuar faktin e paditësit pas konsultimit mjekësor i është përshkruar terapia mjekësore në të cilën është përshkruar gjendja shëndetësore e tij.

Nga përgjigja në kërkesën për lejimin e pushimit mjekësor pa pagesë, të datës 20.06.2023 me nr. 367, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit i është lejuar pushimi mjekësorë për një periudhë një mujore.

Nga përgjigja në kërkesën për lejimin e pushimit mjekësor pa pagesë, të datës 14.08.2023 me nr. 503, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit i është lejuar pushimi mjekësorë për një periudhë një mujore respektivisht nga data 21.08.2023 deri me 20.09.2023 dhe të paraqitet në punë pas skadimit të këtij afati.

Nga vendimi i të paditurës me nr. prot. 368, të datës 20.06.2023 , gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit i është lejuar pushimi pa pagesë mjekësor prej datës 21.07.2023 deri me 20.08.2023, për 1 muaj dhe i njëjti të paraqitet në punë me datë 21.08.2023, me paralajmërimin se është i detyruar të paraqitet në punë në të kundërtën, do të humbë të drejtën e vazhdimin të kontratës së punës.

Nga vendimi i të paditurës me nr. prot. 505, të datës 14.08.2023 , gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit i është lejuar vazhdimi i pushimit pa pagesë mjekësor prej datës 21.08.2023 deri me 20.09.2023, për 1 muaj dhe i njëjti të paraqitet në punë me datë 21.09.2023, me paralajmërimin se është i detyruar të paraqitet në punë në të kundërtën, do të humbë të drejtën e vazhdimin të kontratës së punës.

Nga përgjigja në kërkesën për vazhdimin e pushimit mjekësor pa pagesë edhe për një muaj shtesë, të datës 19.09.2023 me nr. 572, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit i është lejuar pushimi mjekësorë për një periudhë një mujore respektivisht nga data 21.08.2023 deri me 20.09.2023 dhe të paraqitet në punë pas skadimit të këtij afati.

Nga vendimi i të paditurës me nr. prot. 573, të datës 19.09.2023 , gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit i është lejuar vazhdimi i pushimit mjekësor pa pagesë për arsye shëndetësore prej datës 21.09.2023 deri me 20.10.2023, për 1 muaj dhe i njëjti të paraqitet në punë me datë 21.10.2023, me paralajmërimin se është i detyruar të paraqitet në punë në të kundërtën, do të humbë të drejtën e vazhdimin të kontratës së punës.

Nga korrespondenca me Gjykatën- Emaillet dhe ato të datave 13.12.2022, 14.12.2022, 27.10.2023 dhe 30.10.2023, nga të cilat e paditura ka kërkuar informacione lidhur me paditësin, ku edhe nga është njoftuar. Si dhe nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë me nr. 2022:262111, i datës 23.03.2023, i plotfuqishme nga data 26.05.2023.

- *Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës*

Bazuar në provat e administruara dhe të elaboruara në këtë çështje kontestimore rezulton se vendimi i të paditurës mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës të këtu paditësit është nxjerrë në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore të lartcekura, andaj gjykata vendosi që të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shkaqet dhe arsyet si në vijim:

Në nenin 2 të par.1 i Ligjit Nr.06/11-114 për Zyrtaret Publik, i cili ka përcaktuar se “*Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë. Neni 5 i këtij ligji pa paraparë që “ Zyrtarë publikë janë: 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik”*. Ndërsa sa i përket asaj se kush hyn në kuadër të nëpunës të shërbimeve publike , par.4 ka përcaktuar që “*nëpunës i shërbimeve publike “Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës”*, e duke qenë se objekt trajtimi në këtë çështje është vendimi i të paditurës me të cilin paditësit i është ndërprere marrëdhënia e punës, i cili e ka ushtruar pozitën e Teknikut të Laborantit të Biokimisë Hematologjike, sipas vlerësimi të kësaj gjykate, kjo pozitë hyn në kuadër të nëpunësit të Shërbimeve Publike.

Paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën i sistemuar në vendin e punës Teknik në Laboratorin Biokomik Hematologjik, i njëjti kishte parashtruar kërkesë për pushim mjekësor pa pagës me arsyet për trajtim shëndetësor jashtë vendit, e njëjta kërkesë i është aprovuar tri herë radhazi nga ana e të paditurës për tre muaj përkatësisht për periudhën prej 21.07.2023 deri më 20.10.2023. Gjykata ka vërtetuar se paditësi gjatë kohës sa ishte në mbajtje të dënimit për veprën penale të shqiptuar ndaj tij, tek e paditura njëkohësisht ishte në pushim mjekësor.

Gjykata vlerëson se ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit nga ana e të paditurës ka ardhë si pasojë e dënimit të tij me Aktgjykim të Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr.2022:262111, të datës 23.03.2023, i plotfuqishëm më datë 26.05.2023, me të cilin është shpallur fajtorë për shkak të kryerjes së veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, si dhe i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e tre (3) muaj si dhe dënim me gjobë në vlerë prej 600 euro. Kjo duke ju referuar Ligji me nr. 08/L-197, për Zyrtarët Publik (tutje Ligji Nr.08/L-197), në nenin 73, par 1.6, ka paraparë se: “*Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon për rastet e përcaktuara në ligj, kur: 1.6. Dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje”*. Ndërsa me nenin 87 par. 1, të këtij ligji ka paraparë se: “*Ndërprerja e marrëdhënies së punës për nëpunësin/in e shërbimit publik bëhet përshtatshmërisht, në bazë të nenit 72,73,74 dhe 75 të këtij ligji.”* Andaj e paditura ka vepruar konform dispozitave të lartcekura, ku pas informimit për dënimin e shqiptuar ndaj paditësit dhe faktin se i njëjti ishte në mbajtje të dënimit, sipas fuqisë ligjore ka marrë vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës te të njëjtit.

Në rastin konkret përgjegjësia e paditësit është vërtetuar edhe me aktgjykim të formës së prerë me të cilin i njëjti është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale me dashje siç parashihet edhe me nenin 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore me nr. 03/L-006 se : *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit është lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*. Në fakt, se paditësi është dënuar me aktgjykim të formës së prerë nuk është kontestuar as nga pala paditëse.

Pretendimi i paditësit se në këtë rast është dashur të zbatohet Ligji Nr.03/L-212 i Punës, përkatësisht neni 67 par.2 i të njëjti ku është përcaktuar se *“Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet : nëse i punësuari shkon në vuajtje të dënimit i cili do të zgjasë më tepër se gjashtë (6) muaj”*, mirëpo këtë pretendim gjykata nuk e mori për bazë, për faktin se referuar nenit 2 të ligjit Ligji Nr.08/L-197, ku parashihet se *“Ky ligj zbatohet për zyrtaren/in publik në institucionin publik të Republikës së Kosovës. 2. Përgjithësisht, marrëdhënia e punës së zyrtares/it publik rregullohet ndryshe, vetëm kur parashihet shprehimisht me këtë ligj”* gjykata e vlerësoj por të njëjtin nuk e mori për bazë, pasi që referuar dispozitat të Ligji Nr.08/L-197, në mënyrë të detajuar ka përcaktuar rregullimin marrëdhënies së punës së zyrtarit publik dhe masat disiplinore, pra nuk ka paraparë ndonjë dika tjetër nga ajo që është përcaktuar në nenin 72,73,74 dhe 75 e lidhur me nenin 87 të këtij ligji.

Sa i përket pretendimit të paditësit, se e paditura gabimisht ka vlerësuar të drejtën materiale, përkatësisht pretendimit se nuk janë përdorur dispozitat më të favorshme të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e marrjes aktgjykimit, gjykata thekson se vendimi i të paditurës me nr. 685, i datës 31.10.2023 i cili është objekt kontesti në këtë lëndë është marrë në përputhje me ligjin për Zyrtar Publik nr.08/L-197, i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e marrjes së këtij vendimi mbi përfundimin e marrëdhënies së punës së paditësit, andaj kjo gjykatë vlerëson se koha kur është bërë i plotfuqishëm aktgjykimi penal, sa i përket aplikueshmerisë së ligjit në fuqi nga ana e të paditurës nuk është relevante pasi që në kohën kur e paditura ka marrë vendimin në fuqi ka qenë ligji për zyrtar publik nr.08/L-197, kjo duke marrë pra vendimin e saj e ka marrë konform legjislacioni në fuqi, duke i shtuar kësaj edhe faktin se parimi i aplikimit të dispozitave më të favorshme ndaj paditësit nuk aplikohet tek marrëdhëniet e punës.

Po ashtu sa i përket pretendimeve të palës paditëse se vendimi i cili është objekt i këtij kontesti është totalisht i pa arsyetuar dhe përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, si dhe nuk i plotëson kriteret dhe elementet e detyrueshme të një akti administrativ. Sipas kësaj gjykate një pretendim i tillë është i pa bazuar pasi që vendimi i cili është objekt në këtë çështje në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje të plotë me nenin 47 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që dispozitivi i të njëjtit është i hartuar në mënyrë të rregullt, ndërsa përmban edhe arsyetimin i cili është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes.

Nga sa u tha më lartë, gjykata nuk ka gjetur se e paditura ka bërë shkelje të dispozitave ligjore nga Ligji për Zyrtarët Publik, përkatësisht paditësi nuk ka vërtetuar të ketë pasur shkelje, prandaj

vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që refuzoi në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, e mori sipas nenit 450 të LPK-së,

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, konform nenit 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2298/23 me datë 05 korrik 2024

G j y q t a r j a,
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.